

---

Commendatio animae - Lutje paradigme dhe skena biblike në ritin mortor paleokristian nga provinca Praevalis / *Commendatio animae – Paradigm Prayer and Biblical Scenes of the Early Christian Funerary Ritual in the Praevalis Province*

Gëzim Hoxha

---

**Citer ce document / Cite this document :**

Hoxha Gëzim. Commendatio animae - Lutje paradigme dhe skena biblike në ritin mortor paleokristian nga provinca Praevalis / *Commendatio animae – Paradigm Prayer and Biblical Scenes of the Early Christian Funerary Ritual in the Praevalis Province*. In: Iliria, vol. 34, 2009. pp. 131-152;

doi : <https://doi.org/10.3406/iliri.2009.1085>

[https://www.persee.fr/doc/iliri\\_1727-2548\\_2009\\_num\\_34\\_1\\_1085](https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_2009_num_34_1_1085)

---

Fichier pdf généré le 19/03/2019

Gëzim HOXHA

**COMMENDATIO ANIMAE - LUTJE PARADIGMË DHE SKENA  
BIBLIKE NË RITIN MORTOR PALEOKRISTIAN NGA  
PROVINCA PRAEVALIS\***

DANIEL DE LACO LEONIS  
TRIS PVERI DE ECNE CAMI  
SVSANA DE FALSO CRIMINE  
DIVNAN DE VENTRE QVETI LIBERATUS EST  
ABRAM ETET EVAM  
DOMNVS LAIARVM *resuscitat*  
Petrus virga percouset, fontis ciperunt quorere

**C.I.L. <sub>3</sub>, supp. 1-3, 10190**

**Insc. Lat. Vet. <sup>2</sup> n. 2426**

Gjurmët e periudhës së hershme kristiane në provincën Praevalis paraqesin një aspekt mjaft interesant të historisë së saj. Në tërësinë e tyre, të dhënat burimore për këtë periudhë janë të pakta. Burimet e rralla historike, aktet e koncileve kishtarë dhe korespondenca e trashëguar në mes papëve dhe peshkopëve, japin një panoramë historike, e cila gradualisht po pasurohet me të dhënat e reja të arkeologjisë<sup>1</sup>.

Dy kupa lutjesh me paraqitje figurash biblike nga territori i provincës Praevalis janë dy nga objektet më mbresëlënëse të periudhës paleokristiane. Për tematikën dhe funksionin e tyre të përbashkët, ata do të trajtohen së bashku në këtë punim.

Në Muzeun Historik të qytetit të Shkodrës gjendet një kupë terrasigillata me zbukurime në relief, i cila ka origjinë veriafrikane. Ajo është gjetur në një varrezë në

---

\* Ky artikull është botuar edhe në librin *In Memoriam*, Aleks Buda në 100 vjetorin e lindjes. Tiranë, 2010 f. 295-313. Për arsye të një gabimi teknik në shtyp, e gjetëm me vend që ta ribotojmë këtu, me disa plotësime të reja në tekst, me ilustrime me të plota dhe me një përmbledhje në gjuhën angleze.

fshatin Kalldrën, rreth 18 km në veri të Shkodrës, pranë stacionit rrugor *Cinna*, të shënuar në itinerarin *Tabula Peutingeriana*.<sup>2</sup>

Kupa me një diametër prej 17.5 cm është e zbukuruar në anën e saj të brendëshme me figura në relief (Fig. 1). Një figurë mashkullore qëndron mbi një zokol ndërmjet dy luanëve të paraqitur në pozicion kërcënues. Trupi pothuajse lakuriq mbulohet në mes nga një përparje (Perizoma). Pozicioni i duarve dhe i kraheve i përgjigjet më së miri gjestit të atëherëshëm të lutjes, çfarë na kujton skenën biblike nga Testamenti i Vjetër të “Danielit në shpellën e luanëve” (**Dan, 6, 23**). Përkundraill Danielit, një kanistër frutash, me fundin e drejtuar nga qendra e kupës, e plotëson hapësirën boshe pa figura.<sup>3</sup>



Fig. 1. Kupa e Kalldrunit (Danieli në shpellën e luanëve).

Kjo kupë është një enë e veçantë e prodhimit veriafrikian *terra sigillata chiara*, e zbukuruar me paraqitje figurash në relief. Sipërfaqja e lëmuar e anës së brendëshme shërbente si një sfond i përshtatëshëm për figurat në relief të realizuara me matrice. Enë të tilla qeramike të cilësisë së lartë kanë qenë prodhuar që prej shekullit të III pas. Kr. në Afrikën e Veriut<sup>4</sup>. Kështu, “Kupa e Kalldrunit,, përbën një dëshmi kuptimplote për veprimtarinë e eksportuese të punishteve të antikitetit të vonë. Për një

<sup>1</sup> Për procesin e kristianizimit në këtë provincë shih: DUVAL, POPOVIĆ, 1984, f. 552-554; MIJOVIĆ, 1978, f. 641-678; HOXHA, 2003 f. 109-127, 177-178; HOXHA, 2005, f. 169-191.

<sup>2</sup> TAB PEUT. MILLER. IR. COL. 462-471; Shih edhe ANAMALI, KOMATA, 1978, f. 104-106.

<sup>3</sup> ALBANIEN, 1988, Kat. Nr. 355, f. 443, përgatitur nga S. Anamali.

<sup>4</sup> SALOMONSON, 1979, f. 51-57.

eksport të tillë dëshmojnë tanimë edhe shumë enë apo fragmente enësh terra sigillata të prodhimit veriafrikian, të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike në qytetin e Shkodrës (Scodra)<sup>5</sup> dhe së fundmi në qytetin e Lezhës (Lissos-Lissus)<sup>6</sup>.

Prej kohësh është vërejtur se në kuadrin e ndryshimeve fetare në shekujt III dhe IV pas Kr. në kupa të tilla me zbukurime në relief janë paraqitur skena pagano-mitologjike, neutrale apo së fundi edhe skena kristiane.

Sipas Eusebius nga Cesarea, skena me paraqitjen e “Danielit në shpellën e luanëve” ishte një nga emblemat më të preferuara të perandorit Konstantini i Madh.<sup>7</sup> Në shekullin e III pas Kr. kjo skenë ka qenë paraqitur në pikturat e monumenteve mortore në Romë. Në sargofagët paleokristianë, kjo skenë shfaqet për herë të parë në gjysmën e dytë të shekullit të III pas. Kr. Më vonë ajo u paraqit gjithnjë e më shpesh në artet figurative. Këtij grupi i përket gjithashtu edhe “Kupa e Kalldrunit” e Muzeut Historik të Shkodrës.

Në pikpamje studimore mund të debatohet nëse motivi ynë mund të ketë lindur si reminishencë nga repertori figurativ i kohëve pagane. Fakti që Danieli i kësaj kupe mban një përparje (Perizoma) dhe është i pozicionuar ndërmjet dy luaneve do të mund interpretohej si një ndikim nga ndeshjet luftarake në arenat e amfiteatrove ose të kuptohej si një nga skenat e të ashtuquajturve martirë “*ad leones*”<sup>8</sup>.

Studiues të fushës së artit paleokristian e kanë venë në dukje faktin se Noe, Danieli, tre të rinjtë hebrej, dhe nga një herë edhe Abrahami me Isakun paraqiten me duart e ngritura lart, në një mënyrë të atillë, sa që me të drejtë këto trajtesa të mund të karakterizohen si “orantë biblikë”. Lutja për shpëtim këtu duket se është shprehur qartë.<sup>9</sup>

Edhe në “Kupën e Kalldrunit” kemi të bëjmë pikërisht me një “orant të tillë biblik”, i cili personifikohet tërësisht me lutjen për shpëtim. Këtë e tregojnë më së miri elementet ikonografike të skenës së paraqitur në relief. Pozicioni i qëndrimit si orant i figurës njerëzore në mes të dy luanëve kërcënues, por të shtangur, tregon qartë se këtu kemi të bëjmë me shpëtimin e mbinatyrshëm të profetit Daniel<sup>10</sup> (**Dan, 6, 23**).

Një kupë e tille e ngjashme e zbukuruar me figura në relief, nga Koleksioni Karl Löffler, është botuar në vëllimin e III të katalogëve shkencorë të Römisch-Germanisches Museum të Këln-it (Gjermani)<sup>11</sup>. Kupa me origjinë nga Afrika e Veriut paraqet të njëjtën skenë biblike, por me disa ndryshime stilistike nga “Kupa e Kalldrunit” ( Fig. 2). Në

<sup>5</sup> HOXHA, 1995. f. 249-266.

<sup>6</sup> HOXHA, 2007, f. 85-86 : Shih edhe raportet e gërmimeve arkeologjike në Lezhë ne vitet 2006-2007, veçanërisht sektorët B dhe C. Ruhen në Arkivin e Institutit Arkeologjik Tiranë.

<sup>7</sup> Vita Const. 3, 49.

<sup>8</sup> WILPERT, 1903, f. 42 dhe 335; WACKER, 1954, f. 10, 37

<sup>9</sup> STUIBER, 1957, f. 168,

<sup>10</sup> STUIBER, 1957, f. 168, 183-184, 186-192

<sup>11</sup> LA BAUME- SALOMONSON, 1976, Nr. 603, Taf. 60, 3; SALOMONSON, 1979, f. 55-57 Pl. 45; E njëjta kupë tek : AUSSTELLUNG FRANKFURT, 1983, f. 683-684, nr. kat. 261.

pikpamje ikonografike, skena e Danielit në kupën tonë gjen më shumë paralele me paraqitjen e këtij profeti në një relikuar prej argjendi të gjetur në Nea Herakleia (Kalkidikë-Greqi), i cili ruhet sot në Muzeun Arkeologjik të Selanikut.<sup>12</sup> ( Fig. 3)



Fig. 2. Kupa e Këlnit nga Koleksioni K. Löffler (sipas Sörries, 2005, Kat. 284, Taf. 24).



Fig. 3. Relikuari nga Nea Herakleia (sipas Buschhausen, 1984, Abb. 1 S. 344).

Paraqitja e skenës biblike “Danieli në shpellën e luanëve” është një dukuri e njohur në objektet e periudhës paleokristiane në territorin e Ilirikut. Mund të përmendim këtu realizime skenash të tilla në pikturë, të paraqitura në tre varre paleokristiane nga Selaniku.<sup>13</sup> Dy paraqitje tjera, respektivisht nga një mozaik dhe nga një sargofag, vijnë nga Poreçi (Parentium - Kroaci).<sup>14</sup> Kjo skenë është realizuar edhe në dy relikuarë me origjinë nga Novalje (Kroaci)<sup>15</sup> dhe Nea Herakleia (Kalkidikë-Greqi)<sup>16</sup> (Fig. 3). Një shembull domethënës përbën edhe paraqitja e kesaj skene në mes të figurave biblike të skalitura në një kupë qelqi me origjinë nga Podgorica<sup>17</sup> (Mali i Zi) (Fig. 6-13). “Danieli në shpellën e luanëve” është paraqitur si figurë në relief në tri pllaketa prej balte, të gjetura në gërmimet në kështjellën e Vinica-s (Maqedoni)<sup>18</sup> ( Fig. 4), dhe në gdhendjen mbi një bisht krehëri prej kocke, të gjetur në varrezën e Kranj-Lajh-ut

<sup>12</sup> BUSCHHAUSEN, 1984, f. 343-347, fig. 1

<sup>13</sup> PAZARAS, 1981, f. 373-389 ; SÖRRIES, 2005, nr. Kat. 71-73, f. 58-59.

<sup>14</sup> Shih respektivisht për paraqitjen ne mozaik: PRELOG, 1994, Tab. XXX dhe XXXIII: dhe për paraqitjen në sargofag : DRESKEN-WEILAND, 1998, f. 153.

<sup>15</sup> Sjaž zadarskih riznica. Sakralna umjetnost na produkcju. Zadarske nadbiskupije od IV do XVIII. Stoljeca, Zagreb, 1990. nr.kat. 18, f. 301.

<sup>16</sup> BUSCHHAUSEN, 1984, f. 343-347, fig. 1

<sup>17</sup> LEVI, 1963, f. 55-60; BANC, 1966, fig. 27-31, teksti f. 281; LJUBNIKOVIAE-COROVIAE, 1967, f. 85-92

<sup>18</sup> BALABANOV, KRSTEVSKI, 1991, f. 16, 28-29, fig. 69, f. 43



Fig. 4. Pllakë balte nga Vinica (Maqedoni) (sipas Balabanov-Krstevski, 1991).

(Slloveni).<sup>19</sup> ( për të gjitha gjetjet e sipërpërmendura shih hartën Fig. 5)

Duke u mbështetur tek ikonografia e Danielit me përparje (Perizoma)<sup>20</sup> ashtu edhe mbi bazën e kontekstit arkeologjik të gjetjes, “Kupa e Kalldrunit” mund të datohet në mesin e shekullit të IV pas. Kr.<sup>21</sup> Në mbështetje të këtij datimi ne po sjellim edhe një argument tjetër,




Fig. 5. Ilirik, gjetjet me paraqitjen e “Danielit në shpellën e luanëve”.

<sup>19</sup> STARE, 1980, f. 78; KNIFLE, SAGADIN, 1991. nr. kat. 68, f. 108

<sup>20</sup> Krahaso shembujt tek: WACKER, 1954, f. 10; BUSCHHAUSEN, 1984, f. 343-347, fig. 1-3

<sup>21</sup> ANAMALI, KOMATA, 1978, f. 104-106; SÖRRIES, 1983, f. 24-25.; ALBANIEN, 1988, Kat. Nr. 355, f. 443, përgatitur nga S. Anamali.

faktin që kjo kupë e Kalldrunit është gjetur së bashku me një enë tjetër terra sigillata afrikanoveriore e tipit të njohur Atlante XLVIII, 14<sup>22</sup>, e datueshme gjithashtu në mesin e shek. IV pas. Kr.

Mund të pranohet se kjo kupë ka shërbyer si një objekt kulti në ceremonitë fetare mortore. Vendgjetja e saj në hapësirën e një varreze, forma fizike e saj, pa fund, ashtu edhe paraqitja figurative në relief me një skenë biblike, na tregojnë për këtë funksion. Ka shumë gjasa që përdorimi i saj në procesin celebrues të varrimit, ka qenë shoqëruar me lutjen paradigmatike (standart) të llojit *Ordo commendationis animae*.<sup>23</sup>

Kryerjen e një lutjeje të tillë na e tregon në mënyrë më të plotë edhe një gjetje e vjetër me origjinë nga varreza perëndimore e qytetit të Doclea-s,<sup>24</sup> jo më tepër se 30 km në veri të vendgjetjes së Kalldrunit. Bëhet fjalë për të ashtuquajturën “Kupa e Podgoricës”.

Jo vetëm skenat biblike të paraqitura në këtë kupë prej qelqi, por edhe historia e gjetjes dhe ndryshimet e zotëruesve të saj, duke kaluar nga një dorë në tjetrën, paraqesin aspekte mjaft interesante të historisë së këtij objekti me vlera të jashtëzakonshme.

Kupa prej qelqi është gjetur rastësisht, mbas një beteje në mes turqëve dhe malazezëve, ndoshta në vitin 1870, gjatë punimeve për hapjen e një varri brenda sipërfaqes së një varreze antike<sup>25</sup> (Fig. 6). Pak kohë më pas ajo u bë pronë e konsullit të atëhershëm italian në Shkodër M. Perrod, i cili e ekspozoi këtë gjetje në muzeumin e tij. Këtu kupa u pa për herë të parë nga ish drejtori i shkollës franceze në Athinë A. Dumont, i cili e skicoi dhe e publikoi këtë skicë në vitin 1873<sup>26</sup>. Ky publikim tërhoqi vëmendjen e një prej themeluesve të arkeologjisë kristiane J. B. de Rossi, i cili, mbi bazën e skicimit të publikuar nga Dumont, i bëri një publikim paraprak kësaj kupë në vitin 1874.<sup>27</sup>

Me synimin për të lexuar saktë mbishkrimet e kësaj kupe, ai u përpoq të gjente mundësi për ta parë me sytë e vet këtë objekt, por fillimisht nuk pati sukses. Në atmosferën e luftërave ballkanike, zotëruesi i kupës u shpërngul nga Shkodra në Sarajevë. Atje kupa u ble nga koleksionisti me origjinë ruse A. Basilewski, i cili asokohe jetonte në Paris.<sup>28</sup> Pikërisht këtu Basilewski e ftoi të mirënjohurin de Rossi dhe e befasoi duke ja treguar kupën e shumkërkuar prej qelqi. Përveç kësaj, ai i vuri në dispozicion de Rossit edhe një vizatim mjaft të saktë, me qëllimin që ai ta studionte dhe ta publikonte në mënyrë më të plotë.<sup>29</sup> Me shitjen koleksionit Basilewski mbaroi edhe „odisea” e „Kupës së Podgoricës,, Me këtë ndryshim pronësie, ajo fitoi qytetarinë e Shën Petërsburg-ut dhe gjendet edhe sot në koleksionin e Muzeumit “Ermitage,,<sup>30</sup> Nga ajo kohë e

<sup>22</sup> “ATLANTE, 1981, f. 105-106, Tav. XLVIII, 14-15. Fotografi të këtyre dy kupave janë publikuar edhe nga SÖRRIES, 1983, fig. 29.

<sup>23</sup> STUIBER, 1957, f. 169-170

<sup>24</sup> Për vendgjetjen e saktë ka shkruar LJUBNIKOVIAË-ËOROVIAË, 1967, f. 91

<sup>25</sup> STICOTTI 1913, f. 39 dhe shënimi nr. 44 në këtë faqe

<sup>26</sup> DUMONT, 1873, f. 71-73 ;

<sup>27</sup> DE ROSSI, 1874, f. 153

<sup>28</sup> DARCEL, BASILEWSKI, 1874

<sup>29</sup> DE ROSSI, 1877, f. 86-95, Pl. V-VI; DE ROSSI, 1884-1885, f. 86-94

<sup>30</sup> BANC, 1966, fig. 27-31, teksti f. 281

deri më sot, d.m.th qysh prej 140 vjetësh, kjo kupë qelqi me skenat biblike të paraqitura në të, ka qenë vazhdimisht një objekt kërkimesh e studimesh.<sup>31</sup>

Por, i pari përparim i rëndësishëm në interpretimin e skenave biblike të paraqitura dhe në leximin mbishkrimeve pranë tyre, mbetet puna themelore e E. Le. Blant mbi sargofagët paleokristianë të qytetit Arles<sup>32</sup> të provincës Gallia Narbonensis (sot, në Francën e Jugut). Mbi bazën e këtij punimi lindën më vonë punime të tjera të rëndësishme të studiuesve si P. Levi<sup>33</sup>, A. Banc<sup>34</sup> dhe M. LjubnikoviæËoroviæ<sup>35</sup>.



Fig. 6. "Kupa e Podgoricës".

<sup>31</sup> DUMONT, 1873, f. 71-73; DE ROSSI, 1874, f. 153.; DE ROSSI, 1877, f. 86-95 Tab. V-VI.; LE BLANT, 1878, f. XXVIII-XXX, pl. XXXV; GARRUCI, 1881, tome VI, pl. 443, nr. 3; MORWAT, 1882, f. 296-297.; KRAUS, 1882, f. 614, Fig. 220.; G. B. DE ROSSI, *Bulletino di Archeologia Cristiana*, serie quarta, anno terzo, Roma, 1884-1885, f. 91; PERATE, 1892, f. 351-352, fig. 241.; CABROL, LECLERCQ, 1914, f. 3008-3011, fig. 3336.; WULF, 1914, f. 69-70, Abb. 55.; MARUCCHI, 1923, f. 292-293; DELA FERTE, 1958, f. 110.; LEVI, 1963, f. 55-60, fig. 1-4.; BANC, 1966, Fig. 27-31, teksti f. 281; ICG, 1967, f. 263-264, fig. 17; LJUBNIKOVIAËËOROVIAË, 1967, f. 85-92; *Iskusstvo Vizantii v Sobranija SSSR*, Moskva, 1977, Kat. Nr. 92, f. 76; MIJOVIAË, 1987 f. 84-86, fig. 36-37; MIJOVIAË, 1980, f. 96; KAISER-MIN, 1983, f. 325, fig. 142; LEVI, 1993, f. 158-166; PIPEROVIAË, 2001, f. 38-39

<sup>32</sup> LE BLANT, 1878, f. XXVIII - XXX, pl. XXXV.

<sup>33</sup> LEVI, 1963, f. 55-60; LEVI, 1993, f. 158-166

<sup>34</sup> BANC, 1966, fig. 27-31, teksti f. 281.

<sup>35</sup> LJUBNIKOVIAËËOROVIAË, 1967, f. 85-92



“Kupa e Podgoricës” është një “*patera*” (kupë për kryerjen e lutjes) e punuar në qelq të bardhë transparent dhe ka formë të thjeshtë konkave pa fund. Diametri i saj në buzë është 24 cm., ndërsa thellësia është 5.5 cm. Figurat dhe mbishkrimet shoqëruese të tyre janë realizuar me teknikën e gërvishtjes në sipërfaqen e brendëshme të kupës.

Këtu janë paraqitur shtatë skena me subjekt nga Testamenti i Vjetër dhe një skenë me subjekt nga Testamenti i Ri. Në qendrën e kupës është vendosur skena me sakrificën e Abrahamit (**Zan, 22**, 1-19), e cila ndjek qartë ikonografinë e zakonshme të temës dhe ka të shprehura qartë disa elemente figurative nga arti kopt.<sup>36</sup>

Ndërsa për rreth kësaj skene qendrore janë vendosur në mënyrë rrethore shtatë skena biblike të shoqëruara me mbishkrime latine, të shkruara në shumicë me germa të mëdha (*majuscule*), por disa pjesë edhe me germa të vogla (*minuscule*).

1. DANIEL DE LACO / LEONIS -

(Danieli në shpellen e luanëve) (**Dan., 6**, 23), ( fig. 12)

2. TRIS PVERI DE EGNE / CAMI -

(Tre të rinj hebrej në furrën e zjarrtë) (**Dan, 3**, 20-30), ( fig. 13 )

3. SVSANA / DE FALSO CRI / MINE.-

( Suzana shpëton nga akuza e rreme ) (**Suppl. Dan, 13**), ( fig. 10)

4. DIVNAN DE VENT / REQVETI LIBERATUS EST.-

(Profeti Jonas shpëton nga gëlltitja e balenës) (**Gio, 1-4**). ( fig. 9 )

5. ABRLM ETET EV/AM -

( Adami dhe Eva pranë pemës së njohjes) (**Zan, 3**, 20; **4**, 1, 25; **5**, 1-5) (fig. 7),

6. DOM NVS / LAIARVM / re/suscitat -

( Jezu Krishti ringjall Lazarin) (**Gen,11**, 1-44), (fig. 11)

7. *Petrus virga perco/uouset / fontis cipe/runt quore/re -*

Pjetri ( në vend të Moisiut) qëllon me shkop...burimet fillojnë të rrjedhin)

(**Es. 17**, 1-7), (fig. 8 )

Në mbishkrimet shoqëruese të skenave të veçanta janë vërejtur disa gabime të natyrës gjuhësore<sup>37</sup> dhe përmbytësore. Në mbishkrimin e skenës së “*mëkatit të parë*” në vend të emrit ADAM është shkruar gabimisht ABRAM (Fig. 7). Në skenën e njohur të Moisiut nga Testamenti i Vjetër, në vendin e shkëmbit Oreb është vendosur një pemë palme, e cila në traditën e hershme kristiane ishte simbol i jetës<sup>38</sup>. Po ashtu në mbishkrimin shoqërues të kësaj skene, në vend të emrit Moisi është shkruar emri i apostullit Pjetër. (Fig. 8)

<sup>36</sup> LJUBNIKOVĽËËOROVĽË, 1967, f. 90.

<sup>37</sup> Sipas renditjes së tekstit të sipërshkruar, mbishkrimet bashkëshoqëruese të skenave të paraqitura do të lexoheshin kështu në mënyre korrekte:

DANIEL DE LACO LEONIS, TRES PUERIDE IGNE CAMINI, SUSANNA DE FALSO CRIMINE, JONAS DE VENTRE CETI LIBERATUS EST. ADAM ET EVAM, DOMINUS LAZARUM resuscitat, *Petrus virga percutit...fontes ciperunt currere.*

<sup>38</sup> LEVI, 1963, f. 59




Fig. 7. Adami dhe Eva.



Fig. 8. Mrekullia e Shën Pjetrit (Moisiut).

Skena e Adamit dhe Evës përputhet në mënyrën e saj të kompozimit me shumicën paraqitjeve të ruajtura të skenës së „mëkatit të parë”. Prindërit e zanafillës paraqiten në të ashtuquajturën skemë figurative simetrike, me qëndrimin në këmbë djathtas dhe majtas një peme. Për ikonografinë e kësaj skene mund të konstatohet se këtu ka ngjashmeri figurative me paraqitjet të skenave të tilla në monumentet perëndimore të plastikes së sargofageve dhe të pikturës së katakombeve.<sup>39</sup>

Katër mbishkrimet e para janë formuluar njëlloj, të lidhura përmbajtësisht me shprehjen *liberatus est*, e cila është shkruar vetëm tek mbishkrimi pranë skenës me profetin Jonas. (Fig. 6 dhe 9 )

Të bazuar në historinë e dogmës kristiane, artistët paleokristianë përpiqeshin të paraqisnin kryesisht figura magjike të shpëtimit të mrekullueshëm. Ata kishin dijeni se profeti Jonas ishte një prej këtyre rasteve më të spikatura.<sup>40</sup> Prandaj ai gjendet i paraqitur




Fig. 9. Shpëtimi i profetit Jonas.

<sup>39</sup> DRESKEN-WEILAND, 1991, f. 107, 113.

<sup>40</sup> NARKISS, 1979, f. 64

shpesh së bashku me Noen, të mbrojtur nga përmbytja, Danielin e shpëtuar nga luanët, dhe tre të rinjtë hebrej, të shpëtuar nga furra e zjarrtë.

Praqitja e skenave të tilla, të lidhura përmbajtësisht, u referohet shembujve të shpëtimit pas kryerjes së lutjes. Me ndihmën e Zotit, viktimat njerzore është nxjerrë nga rreziku dhe është shpëtuar. Për këto mrekulli ekzistojnë tekste të panumërta, që rendisin njëri pas tjetrit elemente të shumta biblike. Të tilla koleksione shembujsh, të quajtura *Summarien*, kanë qenë themeli bazë për formulimet e lutjeve.

Tek ky themel e kanë burimin të ashtuquajturat lutje-paradigmë (standart).<sup>41</sup> E tillë është lutja për të vdekurit e njohur si : *Commendatio animae* ( të falat e shpirtit). Në versionin e saj latinisht, kjo lutje është dëshmuar që nga fillimet e shekullit të V, por sipas burimeve është ende shumë më e vjetër<sup>42</sup>. Si skenat figurative ashtu edhe lutjet kanë si burim të përbashkët rezervën e Sumarieve kristiane të herëshme. Pjesët e tyre përkatëse në Testamentin e Vjetër janë ndikuar fuqishëm nga tradicioni judist i vonë dhe nga lutjet greke të kohës antike<sup>43</sup>. Ndërthurje të tilla të paraqitjes së figurave biblike me lutjet përkatëse, i qëndrojnë besnike temës së shpëtimit në trajtën e një mrekullie të Zotit.

Ka raste kur lidhja ndërmjet pamjes figurative shpëtuese dhe fatit të të vdekurit mund të jetë aq e fortë, sa personazhi i vdekur të mund të barazohet me trajtën biblike. Këta kombinime përmbajtësore i referohen shpesh gjendjes së individit pikërisht në periudhën e ndërmjetme në mes të vdekjes dhe ringjalljes. Në këtë mënyrë i urohej atij qëndrimi në përrshpirtshmërinë e përkohëshme gjatë kësaj periudhe kalimtare<sup>44</sup>. Por është vërejtur se ky vargan shpëtues nuk ka lidhje të vetme me fatin e të vdekurit. Vetë natyra e lutjeve tregon se ato mund të përdroreshin edhe për të gjallët në nevojë.

Këto lutje standart fillojnë gjithmonë me një shprehje në trajtë thirrjeje : “*Libera nos Domine, ... sicut liberasti...*” (Shpëtoje o zot, ... siç ke shpëtuar...). Në këtë mënyrë ata sillnin nga Bibla në kujtesën e njerëzve mrekullitë e njohura të Zotit. Është konstatuar se vetëm forma e lutjes mbetet standart. Ndërsa lista e mrekullive të përmendura ndryshon me kalimin e kohës, apo në përputhje me skenat figurative të paraqitura.

Përputhjet ndërmjet skenave biblike dhe mbishkrimeve shoqëruese në “Kupën e Podgoricës” për herë të parë janë ballafaquar nga E. Le Blant, me tekstet origjinale të konstitucioneve apostolike, të veprave të jetës dhe passioneve të martirëve. Në këtë mënyrë ai ka arritur ta formulojë kështu lutjen përkatëse:

<sup>41</sup> STUIBER, 1957, f. 168-171; P. LEVI, 1963, f. 56-57.

<sup>42</sup> KAISER-MIN, 1983, f. 325

<sup>43</sup> LE BLANT, 1878, f. XXIX, shënimi nr.10 ; STUIBER, 1957, f. 172 ; KLAUSER, 1961, f. 128-145 ; LEVI, 1963, f. 56-57; WEITZMANN, 1964, f. 401.

<sup>44</sup> STUIBER 1957, f. 173-175

“Libera nos, Domine, animam ejus, sicut liberasti,  
 Danielelem de lacu leonum,  
 tres pueros de camino ignis,  
 Susannam de falso crimine,  
 Jonam de ventre ceti...,  
 Mosem de manu Pharaonis,..”<sup>45</sup>

“Shpëtoje o Zot, shpirtin e shërbëtorit tënd/ ashtu siç ke shpëtuar,  
 Danielin nga shpella e luanëve,  
 tre të rinjtë hebrej nga furra e zjarrtë,  
 Suzanën nga akuza e rreme,  
 Jonas-in nga barku i balenës...  
 Moisiun nga duart e Faraonit,...”<sup>46</sup>

Prania e dy llojeve të shkrimit (*majuscule dhe minuscule*) dhe disa pasaktësira në këto mbishkrime shoqëruese, kanë çuar drejt mendimit se këtu mund të njihen dy duar mbishkrimesh dhe se mjeshtri i mbishkrimeve nuk ka qenë një latinishtfolës i lindur.<sup>47</sup>

Megjithë problemet ende të diskutueshme si zevëndësimi i Moisiut me Pjetrin, i shkëmbit Oreb me një pemë palme, dhe futja në këtë cikël e skenës me Adamin dhe Evën, ikonografia duket se është menduar në mënyrë shumë të kujdesëshme. Sigurisht që këtu nuk bëhet fjalë për një realizim të llojit “*Biblia pauperum*”, por për paraqitje figurative shpëtuese, të cilat duhej të ishin një thirrje që u drejtohej besimtarëve për forcë besimi dhe durim<sup>48</sup>.



Fig. 10. Skena me Suzanën.



Fig. 11. Ringjallja e Lazarit.

<sup>45</sup> LE BLANT, 1878, f. XXIX. Duke i ndenjbur besnik tekstit në latinisht, të paraqitur nga E. Le Blant, ne kemi ndryshuar këtu vetëm radhën e pjesëve të lutjes në përputhje me skenat e paraqitura në “Kupën e Podgoricës,,

<sup>46</sup> Përkthimi në shqip është ballafaquar edhe me versionin në gjermanisht, të paraqitur nga H. KAISER-MIN, 1983, f. 325.

<sup>47</sup> LEVI, 1963, f. 58, 60.

<sup>48</sup> WACKER, 1954, f. 25

Studiuesve u ka rënë në sy fakti se paraqitjet e skenave biblike janë realizuar në dy stile të ndryshme. Shumica e skenave tregojnë tipare të artit romak të vonë. Skenat me “Sakrificën e Abrahamit”, “Ringjalljen e Lazarit” dhe të “Pjetrit me burimin e mrekullueshëm” janë të ndikuara nga arti kopt <sup>49</sup>.

Po ashtu, me origjinë lindore duket edhe kostumi frigjian që mbajnë tre të rinjtë hebrej dhe vetë Danieli, paraqitjet e të cilit, në shumicën e rasteve të realizuara jashtë Romës, e tregojnë të veshur me kostumin persian apo frigjian.<sup>50</sup> Pikërisht ky element na sjell në kujtesë paraqitje të ngjashme në plastikën e sargofagëve të Ravennës<sup>51</sup> dhe përfrime figurative me skena analoge, të paraqitura në objekte luksi si gema, objekte fildishi apo tekstili<sup>52</sup>.



Fig. 12. Danieli në shpellën e luanëve.



Fig. 13. Tre të rinjtë hebrej.

Po dëshmojmë këtu edhe një analogji shumë të afërt paraqitjeje ikonografike, që vjen nga rrethinat e qytetit të Shkodrës. Kjo është një ampulë prej balte apo pagure pelegrinësh, e cila është e zbukuruar njëlloj në të dy faqet me teknikën e relievit. Brenda një medalioni prej pikash në reliev është paraqitur skena me “Shejtin Menas ndërmjet dy deveve, i cili është veshur me kostumin frigjian dhe qëndron në pozicionin tipik të një oranti<sup>53</sup>. (Fig. 14)

Paralelet këtu janë të qarta, si nga ana e skemës ikonografike, me profetin apo shejtin të vendosur në mes të dy kafshëve, ashtu edhe nga kostumi frigjian që mbajnë Shën Menasi tek ampula e Shkodrës, apo tre të rinjtë hebrej dhe Danieli në “Kupën e Podgoricës”,<sup>54</sup>.

Është vënë re tanimë se në paraqitjet më të herëshme mbizotërojnë skenat nga Testamenti i Vjetër. Shembujt e ngjashëm nga Testamenti i Ri ishin ende në procesin

<sup>49</sup> LJUBNIKOVLAË-ËOROVLAË, 1967, f. 90.

<sup>50</sup> DRESKEN-WEILAND, 1991, f. 150

<sup>51</sup> LAVRENCE, 1945, f. 28, shënimi 141 ; WACKER, 1954, f. 11, 19; MAIOLI, 1978, f. 188-189

<sup>52</sup> MAIOLI, 1978, f. 189, shih edhe literaturën e cituar këtu; SÖRRIES, 2005, f. 44-144. Këtu përfshihet i gjithë katalogu me 337 paraqitje të Danielit në periudhen paleokristiane.

<sup>53</sup> HOXHA, 2003, f. 122-123, fig. 46, f. 178

<sup>54</sup> Madje ekziston edhe mundësia që motivi i Menasit të jetë huazuar për Danielin. Shih për këtë: WACKER, 1954, f. 11, shënimi nr. 1.



Fig. 14. Ampula e Shën Menasit nga Shkodra.

e tyre të lindjes. Në fillim ata paraqiten si një pjesë plotësuese apo shtesë për shembujt e sjellë nga Testamenti i Vjeter<sup>55</sup>. Kjo vlen si për tekstet e përpiluara letrare ashtu edhe për paraqitjet figurative. Një shembull të tillë e paraqet edhe “Kupa e Podgoricës” me një skenë të vetme nga Testamenti i Ri, ku “Krishti ringjall Lazarin”. (fig. 11)

Mangësia e analogjive të plota me “Kupën e Podgoricës” me objekte nga rajonet e pasura me prodhime qelqi si ai Italisë së Veriut apo nga pellgu i lumit Rhein (Gjermani), e lënë ende sot të hapur problemin e vendprodhimit të kësaj kupe.

